



Raport përmbledhës i Gjykatës Supreme

2014

Statistikat, sfidat, planet

Raport përmbledhës i punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në vend. Kryetar i saj është prof.dr. Fejzullah Hasani, ndërsa pjesë e gjykatës janë edhe 12 gjyqtarë.

Gjykata Supreme, bazuar në Ligjin për gjykatat, L 03/99 ka kompetencë të vendosë për:

- Ankesat në shkallë të tretë, të lejuara me ligj;
- Kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj;
- Revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë të gjykatave në çështjet kontestimore, siç është paraparë me ligj;
- Përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës;
- Lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronave, siç parashihet me ligj;
- Në Dhomën e Posaçme, lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, siç parashihet me ligj;
- Çështje të tjera të parapara me ligj

Gjykata Supreme, gjatë vitit 2014, ka pranuar 1004 lëndë, ndërkaq ka trashëguar nga viti paraprak vetëm 114 lëndë. Prej tyre janë kryer 983 lëndë.

S tatistikat

Bazuar në kompetencat e saj, Gjykata Supreme, këtë vit, ka pranuar 1004 lëndë. Në fund të vitit, në punë kanë qenë 1118 lëndë, ndërkaq të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 114 lëndë. Të kryera në këtë periudhë kanë rezultuar 983 lëndë, përderisa të pakryera kanë qenë 135 lëndë.

Ne kemi analizuar punën tonë dhe kemi bërë një krahasim me vitin e kaluar, prej nga rezulton se është rritur efikasiteti i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Nëse në vitin 2013 nga viti paraprak janë trashëguar 904 lëndë, në vitin 2014 kemi vetëm 114 lëndë të trashëguara.

Lloji më i madh i lëndëve të pranuar për këtë vit, është ai për revizion Rev, me 393 lëndë, pasuar nga lëndët e evidentuara si kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë me shifrën PML, 262 sosh, si dhe me kërkesat për zbutje të dënimeve (PZD) me 155 kërkesa të tilla.

Raportin e punës së Gjykatës Supreme për periudhat tremujore prej 01.01.2014 deri më 31.12.2014 mund ta shihni edhe në mënyrë tabelare:

Tremujori i parë: 1.01.2014 - 31.03.2014	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë"API"	-	1	1	1	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	16	67	83	68	15
Kërkesë për zbutje të dënimit"PZD"	2	39	41	33	8
Revizion "Rev"	49	97	146	92	54
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	5	1	6	3	3
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	4	2	6	4	2
Civile të ndryshme "CN"	5	3	8	3	5
Revizione ekonomike "E.Rev"	27	23	50	30	20
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	1	-	1	-	1
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	-	-	-	-	-
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	1	-	1	1	0
A.Rev.	-	3	3	-	3
ARJ	3	4	7	2	5
Ankesa administrative "AA"	1	2	3	3	0
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje"PMLK"	-	1	1	1	0
Ankesa për paraburgime "PN.I"	-	1	1	1	0
Penale Ndihe Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	-	-	-	-	-
Gjithsej	114	244	358	242	116

Tremujori i dytë: 1.04.2014 - 30.06.2014	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë"API"	0	2	2	1	1
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	15	69	84	68	16
Kërkesë për zbutje të dënimit"PZD"	8	39	47	39	9
Revizion "Rev"	54	105	159	98	61
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	3	0	3	3	0
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	2	2	4	1	3
Civile të ndryshme "CN"	5	9	14	8	6
Revizione ekonomike "E.Rev"	20	14	34	23	11
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	1	0	1	1	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	0	0	0	0	0
A.Rev.	3	3	6	6	0
ARJ	5	7	12	3	9
Ankesa administrative "AA"	0	7	7	6	1
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje"PMLK"	0	0	0	0	0
Ankesa për paraburgime "PN.II"	0	2	2	2	0
Penale Ndihme Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	0	0	0	0	0
Gjithsej	116	259	375	259	117

Tremujori i tretë: 01.07.2014-30.09.2014	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "API"	1	2	3	1	2
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	16	58	74	59	15
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	9	35	44	36	8
Revizion "Rev"	61	67	128	69	59
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	0	2	2	1	1
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	3	2	5	4	1
Civile të ndryshme "CN"	6	9	15	14	1
Revizione ekonomike "E.Rev"	11	9	20	9	11
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	0	1	1	1	0
A.Rev.	0	3	3	3	0
ARJ	9	12	21	7	14
Ankesa administrative "AA"	1	12	13	13	0
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "PMLK"	0	0	0	0	0
Ankesa per paraburgime "PN.II"	0	4	4	4	0
Penale Ndihme Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	0	0	0	0	0
Gjithsej	117	216	333	221	112

Tremujori i katërt: 30.09.2014-31.12.2014	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "API"	2	3	5	5	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	15	68	83	68	15
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	8	42	50	38	12
Revizion "Rev"	59	124	183	109	74
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	1	4	5	3	2
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	1	1	2	1	1
Civile të ndryshme "CN"	1	3	4	3	1
Revizione ekonomike "E.Rev"	11	20	31	16	15
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	1	1	0	1
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	0	1	1	1	0
A.Rev.	0	8	8	8	0
ARJ	14	16	30	16	14
Ankesa administrative "AA"	0	1	1	1	0
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "PMLK"	0	0	0	0	0
Ankesa për paraburgime "PN.II"	0	2	2	2	0
Penale Ndihme Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	0	0	0	0	0
Gjithsej	112	294	406	271	135

Ndërkaq, në vijim mund të gjeni të dhënat e kompletuara, në mënyrë tabelare, për vitin 2014:

Raporti vjetor 2014	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "API"	-	8	8	8	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	16	262	278	263	15
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	2	155	157	145	12
Revizion "Rev"	49	393	442	368	74
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	5	7	12	10	2
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	4	7	11	10	1
Civile të ndryshme "CN"	5	24	29	28	1
Revizione ekonomike "E.Rev"	27	66	93	78	15
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	1	1	2	1	1
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	1	1	2	2	0
A.Rev.	0	17	17	17	0
ARJ	3	39	42	28	14
Ankesa administrative "AA"	1	22	23	23	0
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "PMLK"	0	1	1	1	0
Ankesa për paraburgime "PN.I"	0	9	9	9	0
Penale Ndihme Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	0	0	0	0	0
Gjithsej	114	1004	1118	983	135

Gjatë vitit 2014, në përputhje me autorizimet ligjore, Gjykata Supreme përmes Seancave të Përgjithshme, ka dhënë një varg mendimesh juridike, të cilat kanë lehtësuar punën e gjykatave themelore dhe asaj të Apelit, në rastet kur ka pasur paqartësi ligjore apo mundësi të interpretimeve të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe, kolegji i gjykatës, i përbërë nga gjyqtarë vendorë dhe nga ata të EULEX-it kanë dhënë mendime të

ndryshme juridike, të cilat janë publike dhe mund t'i gjeni në ueb-faqen zyrtare të gjykatës.

S fidat dhe të arriturat

Gjykata Supreme, si çdo institucion në vend, është përballur me sfida e probleme të ndryshme, nisur që nga çështjet teknike deri te ato më madhore:

-Sfidë në vete paraqet procedimi i përshpejtuar dhe efektiv, i çështjeve penale që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin, veçmas në gjykatat e instancave të ulëta;

-Sfidë para nesh është edhe decentralizimi i disa kompetencave nga KGJK-ja në Gjykatën Supreme, veçmas menaxhimi i buxhetit, për faktin se kërkon personel shtesë, trajnim të tyre etj.;

-Plotësimi i vendeve vakante për gjyqtarë (mungesa e konkurrencës adekuate);

-Unifikimi i politikave për zbatim unik të ligjit, nëpër gjykatat e Kosovës;

- Sfidë mbi sfidat, për gjykatat e Kosovës në përgjithësi, e për Gjykatën Supreme si autoriteti më i lartë i gjykatave, në veçanti, është ulja e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e instancave më të ulëta dhe rritja e shkallës së besueshmërisë së opinionit në gjykata;

- Sfidë tjetër, mbetet edhe digjitalizimi i sistemit të drejtësisë, ndonëse për këtë sistem është duke u punuar nga USAID/EROL dhe është duke u implementuar projekti TIK/SMIL me mbështetje nga Ambasada Norvegjeze.

Kur flasim për të arriturat, vlen të theksohet rritja e transparencës me publikun, pastaj rritja e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve, ku një ndikim ka ushtruar edhe renovimi i gjykatës, falë projekteve të USAID në Kosovë.

Është i pamohueshëm edhe kontributi i kryetarit të Gjykatës Supreme, Prof. dr. Fejzullah Hasani, në fuqizimin e sundimit të ligjit, përmes aktiviteteve, të karakterit vendorë e ndërkombëtarë.

Po ashtu, Gjykata Supreme ka dhënë kontribut edhe në planin legjislativ: plotësim ndryshimet në ligjin për gjykata; KGJK-në, Akademinë e Drejtësisë, të gjitha këto me qëllim fuqizimin e gjyqësorit.

Në fund të muajit tetor, është publikuar vëllimi i parë për vitin 2014 i Buletinit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Në këtë vëllim kanë dhënë kontribut të çmuar, kryeredaktorja e tij, gjyqtarja Nesrin Lushta, zëvendës-kryeredaktori gjyqtari Avdi Dinaj, gjyqtari Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtari Nebojsa Boricic, bashkëpunëtorja Minire Xhambazi, administratorja Ajna Gashi, etj..

Është me rendësi të theksohet, se Buletini i Gjykatës Supreme të Kosovës, vë në pah punën e instancës më të lartë të sistemit të rregullt gjyqësor në vend, duke sjell para lexuesit përmbledhje të vendimeve të zgjedhura të Gjykatës Supreme. Ky vëllim, përveç faktit të transparencës, synon edhe krijimin e praktikës gjyqësore më funksionale dhe më parimore, duke i mundësuar publikut, e veçanërisht praktikuesve të fushës, mundësinë për të formësuar argumentet e tyre ligjore në mënyrë më të qartë dhe më të qëndrueshme juridikisht.

- **Bashkëpunimi me gjykatat simotra dhe institucione të rëndësishme të drejtësisë në botë:**

Kryetari i Gjykatës Supreme dhe gjyqtarë të kësaj gjykate kanë përfaqësuar institucionin në ngjarje, forume, tribuna e konferenca të rëndësishme, vendore e ndërkombëtare. Vlen të përmendet pjesëmarrja e Kryetarit të Gjykatës Supreme, prof. dr. Fejzullah Hasani, në Konferencën Vjetore për Diplomaci Kulturore 2014, në Gjermani, në shënim të 25 vjetorit të rënies së Murit të Berlinit; pastaj pjesëmarrja e tij në Konferencën Gjqësore Rajonale në Kroaci, në fund të tetorit, me temë "Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale: Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit; pjesëmarrja në simpoziumin mbi të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut, në Mal të Zi, gjatë verës që shkoi; pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të Gjqësorit, në Maltë, (21-23 maj); pjesëmarrja e Kryetarit në Konferencën Rajonale Gjqësore të Projektit të BE-së "Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale, në Tiranë (29 - 30 Prill 2014) etj..


Po ashtu, kryetari i Supremes, prof. dr. Hasani, ka pritur një varg delegacionesh të rëndësishme nga vendi, rajoni e bota, me të cilët janë diskutuar sfidat dhe problemet dhe janë shkëmbyer përvojat, me qëllim funksionimin sa më të mirë të gjykatës.

Kryetari i Gjykatës Supreme dhe gjyqtarë të kësaj gjykate kanë përfaqësuar institucionin në ngjarje, forume, tribuna e konferenca të rëndësishme vendore e ndërkombëtare.. Vlen të përmendet pjesëmarrja e Kryetarit në Konferencën Vjetore për Diplomaci Kulturore 2014, në Gjermani; pjesëmarrja në Konferencën Gjqësore Rajonale në Kroaci; pjesëmarrja në simpoziumin mbi të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut, në Mal të Zi; pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të Gjqësorit, në Maltë; pjesëmarrja në Konferencën Rajonale Gjqësore të Projektit të BE-së "Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale, në Tiranë etj....


Planet për vitin 2015

Gjykata Supreme planifikon që në vitin që vjen, përveç detyrave e përgjegjësisive ligjore, prioritet t'i jap:

- Procedimit të çështjeve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin;
- Kontrolli dhe mbikëqyrja e gjykatave të niveleve më të ulëta rreth procedimit të çështjeve sipas ardhjes nëpër gjykata dhe prioriteteve ligjore - fokusi i Gjykatës Supreme do jetë në mbikëqyrjen e segmentit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, për faktin se në këtë fushë ka defekte të mëdha dhe do të aplikohet një kontroll i rreptë në problemin e parashkrimeve të çështjeve penale nëpër gjykata të instancave më të ulëta;
- Unifikimi i zbatimit të ligjeve nëpër gjykatat e Kosovës
- Plan i përbashkët i gjyqësorit me USAID-in është hapja e ueb-faqeve të reja për KGJK-në, Gjykatën Supreme, atë të Apelit dhe gjykatat themelore. Ndonëse Gjykata Supreme e ka ueb-faqen e saj, ueb-faqet e reja do të mundësojnë qasje më të lehtë për të gjithë sistemin e drejtësisë në vend dhe do të jenë më fleksibile, duke ua lehtësuar punën edhe mediave në veçanti.



Gjykata Supreme do
të jetë gjithmonë
transparente, e
qasshme dhe
llogaridhënëse për
median dhe
publikun!



Kontakti: Tel. +381 (0) 38 243-345; 243 - 348 Fax. +381 (0) 38 245-219

Adresa: Pallati i Drejtësisë, Hajvali

Ueb-faqja: www.gjykatasupreme-ks.org